Buletini Nr. 320/ 2026, 16-11-2026	**Parashikimi** nga 16-11-2026, ora 12:00 deri 17-11-2026, ora 23:59.

PARASHIKIMI I RREZIKUT NGA PËRMBYTJET

Sot pasdite (e hënë, dt. 16) priten reshje me intensitet të lartë në veri të vendit. Në qarqet Shkodër, Kukës dhe Lezhë mund të ketë vërshime të shpejta të lumenjve të vegjël malorë dhe rrëshqitje të dherave. Në zonat urbane, në qarqet Shkodër, Kukës, Lezhë, Durrës dhe Elbasan mund të shfaqen probleme me përmbytje të lokalizuara, në varësi të gjëndjes së kanalizimeve.

PARASHIKIMI METEO

RESHJET

Sot pasdite (e hënë, dt. 16) priten reshje mesatare deri lokalisht intensive në qarqet Shkodër, Kukës, Dibër, Lezhë, Durrës, Tiranë dhe Elbasan, ndërsa në qarkun Vlorë priten reshje mesatare. Në këto qarqe reshjet pritet të shoqërohen me shtrëngata. Në qarqet e tjerë priten reshje të dobëta deri lokalisht mesatare Nesër (e martë, dt. 17) priten reshje të dobëta në të gjithë qarqet (siç tregohet në tabelë, respektivisht për secilin qark).

TEMPERATURA

Nesër (e martë, dt. 17) temperaturat minimale dhe maksimale të ajrit pritet të arrijnë:

në bregdet: 14 / 19 °C

në vendet e ulëta: 12 / 20 °C

në vendet malore: 6 / 15 °C

ERA

Sot pasdite (e hënë, dt. 16) dhe nesër (e martë, dt. 17) era pritet të fryjë mesatare dhe në bregdet deri e fortë.

NIVELET E RREZIKUT	**S'KA RREZIK**	**I ULËT**		**I LARTË**

PARASHIKIMI I DETAJUAR MBI RREZIQET NATYRORE (SOT DHE NESËR)

RREZIKU MAKSIMAL I QARKUT	***Zjarre në pyje***	***Ngjarje Meteorologjike***			***Ngjarje Hidrologjike***		
	Zjarret Mesatarja e qarkut	***Reshje 24-orëshe Mesatarja e qarkut***	***Reshje 24-orëshe Maksimale të lokalizuara***	***Shtrëngata***	***Përmbytje të Shpejta***	***Përmbytje Lumenjsh***	***Rrëshqitje toke***
SHKODËR	S'KA RREZIK	mesatare	intensive				
KUKËS	S'KA RREZIK	mesatare	intensive				
DIBËR	S'KA RREZIK	mesatare	intensive				
LEZHË	S'KA RREZIK	mesatare	intensive				
DURRËS	S'KA RREZIK	mesatare	intensive				
TIRANË	S'KA RREZIK	mesatare	intensive				
ELBASAN	S'KA RREZIK	mesatare	intensive				
FIER	S'KA RREZIK	të dobëta	mesatare				
BERAT	S'KA RREZIK	të dobëta	mesatare				
KORÇË	S'KA RREZIK	të dobëta	mesatare				
VLORË	S'KA RREZIK	mesatare					
GJIROKASTËR	S'KA RREZIK	të dobëta	mesatare				

LEGJENDA: *Reshjet 24-orëshe*


Niveli i Rrezikut	***Reshje shiu*** (mm / 24 orë)
S'KA RREZIK	të dobëta (0 – 15mm / 24 orë) Nuk priten fenomene hidro-meteorologjike problematike.
I ULËT	mesatare (15 – 45mm / 24 orë) Mundësi që të shfaqen fenomene hidro-meteorologjike problematike.
I MODERUAR	intensive (45 – 90mm / 24 orë) Moti parashikohet i rrezikshëm. Parashikohen fenomene të pazakonta hidro-meteorologjike.
I LARTË	shumë intensive (> 90mm / 24 orë) Moti është shumë i rrezikshëm. Parashikohen fenomene të pazakonshme hidro-meteorologjike mjaft intensive.

LEGJENDA: *Zjarre në pyje*

S'KA RREZIK	Zjarret e mundshëm janë të kontrollueshëm lehtësisht.
I ULËT	Barërat e thatë dhe pyjet mund të digjen lehtë. Flakët janë te mesme në pyje dhe të shpejta në zonat e ekspozuara.
I MODERUAR	Ndezja e zjarreve mund të ndodhë lehtë dhe me përhapje të shpejtë. Zjarret mund të jenë shumë të nxehtë, me kurora përhapje të vogla dhe të mesme.
I LARTË	Ndezja mund të shkaktohet edhe nga një shkëndijë. Zjarret janë shumë të nxehtë me përhapje shumë të shpejtë të flakëve si rrjedhim kontrolli i tyre është shumë i vështirë.

SIMBOLE

	Shtrëngata: reshje mbi 20mm/3orë. Moti mund të krijojë probleme të ndryshme
	Përmbytje urbane ose nga përrenjtë dhe lumenjtë e vegjël
	Përmbytje nga lumenjtë e mesëm dhe të mëdhenj
	Rrëshqitje toke



RREZIKU MAKSIMAL I QARKUT
për sot dhe nesër, dt. 16 – 17.